



# **BASHKIA MIRDITE**

## **RAPORTI I MONITORIMIT TE ZBATIMIT TE BUXHETIT (Analiza vjetore)**

# **2025**

## **PËRMBAJTJA**

|                                                                                              |           |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1. Hyrje.....</b>                                                                         | <b>2</b>  |
| <b>2. Realizimi i buxhetit të vitit 2025 .....</b>                                           | <b>3</b>  |
| <b>3. Realizimi i te ardhurave të Bashkisë Mirditë nga burimet e veta për vitin 2025...8</b> |           |
| <b>4. Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2025.....</b>                            | <b>19</b> |
| 4.1 Transferta e pakushtezuar dhe të ardhurat e veta vendore .....                           | 29        |
| 4.2 Transferta e pakushtëzuar sektoriale .....                                               | 31        |
| 4.3 Transferta e kushtëzuar .....                                                            | 35        |
| <b>5. Realizimi i investimeve.....</b>                                                       | <b>39</b> |
| <b>6. Vetëvlerësimi financiar për vitin 2025 për situatën e gjendjes financiare të</b>       |           |
| <b>Bashkisë Mirditë .....</b>                                                                | <b>41</b> |
| <b>7. Analiza e programeve .....</b>                                                         | <b>43</b> |
| 7.1 Programi AA133 Aparati dhe drejtimi i bashkise .....                                     | 43        |
| 7.2 Programi AB133 Punet Publike dhe Mirmbajtja.....                                         | 49        |
| 7.3 Programi AC133 Siguria Publike .....                                                     | 59        |
| 7.4 Programi AD133 Arsimi, Sherbimi Social dhe Kultura.....                                  | 65        |
| 7.5 Programi AE133 Bujqesia, Veterinaria dhe Pyjet .....                                     | 74        |

## 1. Hyrje

Sipas Regjistrit të Gjendjes Civile 2014 Mirdita ka një popullsi prej 37,384 banorësh, dhe një sipërfaqe prej 869.71 km<sup>2</sup>, me densitet prej 42.98 banorë/km<sup>2</sup>.

Bashkia Mirditë gjendet midis koordinatave gjeografike 41° 43' e 41° 59' gjerësi veriore dhe 19° 43' e 20° e 12' gjatësi lindore, duke u kufizuar në veri me Bashkitë e Fushë Arrësit dhe Pukës, në perëndim me të Lezhës dhe në lindje me Bashkinë e Kukësit dhe Dibres. Në jug-lindje kufizohet me bashkinë Dibër, në jug me Bashkinë Mat dhe Kurbin ndërsa në jug-perëndim me bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Rrëshenit.

Bashkia përfshin 4 qytete dhe 81 fshatra, të shpërndara në 7 njësitë administrative përbërëse të saj: Rrësheni, Rubiku, Selita, Kthella, Fani, Oroshi dhe Kaçinari. Bashkia është aktualisht pjesë e qarkut të Lezhës.

Klima:

Klima është mesdhetare kodrinore, paramalore e malore. Bimësia është mjaft e pasur dhe përbëhet nga shkurre, dushqe, pyje të përzier, ahishte e kullota malore. Bimët mjekësore janë mjaft të përhapura. Nga pikpamja fizike territori karakterizohet nga formacione malore, lugina, pllaja, fusha, fushëgropa. Lartësia mesatare shkon 557 m mbi nivelin e detit, maja më e lartë është M. Kunorë (Selitë) (Jo Kunora, Mali i Dejes) 2121 m. Përshkohet nga lumenjtë Fani i Madh, Fani i Vogël, Uraka. Këta lumenj si dhe përrunj të tjerë malorë, kanë jo vetëm kapacitete prodhuese energjetike por edhe për kultivimin e faunes ujore.

Ekonomia:

Zona ka profil ekonomik kryesisht bujqësor dhe blegtoral, ndërkohë që vreshtaria po kthehet në një aktivitet mjaft të përhapur duke krijuar kushte shumë të mira për zhvillimin e agrobiznesit e agroturizmit. Ka pasuri të mëdha nëntokësore, veçanërisht bakër, pirit, krom, të cilat sollën krijimin e katër qyteteve të lidhura me industrinë minerare. Pjesa më e madhe e kësaj industrie aktualisht është jashtë funksionit. Kjo është një nga arsytet që Mirdita shënoi një ndër nivelet më të larta të migrimit të brendshëm si dhe të emigrimit përgjatë 25 viteve të fundit. Per arsye se sipërfaqja e pyjeve në bashkinë e Mirditës është 10 herë më e madhe se fondi i tokës bujqësore, problemet ekologjike të zonës, janë kryesisht të lidhura me pyjet. Trashëgimia kulturore dhe etnografike është mjaft e larmishme dhe unike.

Pas ndërtimit të autostradës A1, Mirdita mori rëndësi si rrugë kalimi dhe si porta natyrore hyrëse për në Kosovë. Ndërtimi i Rrugës së Kombit megjithëse përmirësoi volumnin e levizjes dhe cilësinë e udhëtimit, solli një impakt modest për zhvillimin social-ekonomik të zonës, e cila ka nevojë për impulse të reja zhvillimi.

## **2. Realizimi i buxhetit të vitit 2025**

Realizimi i buxhetit të vitit 2025 është bërë duke respektuar nenin 64 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , ligjin nr. 68/2017 date 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore “, ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligji nr 115/2024 “Për Buxhetin i vitit 2025”, udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njërive të qeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; Udhëzimin plotësues nr. nr.2, date 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” dhe VKB nr.115 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025, VKB nr.20, datë 24.02.2025 “Për miratimin e fondeve te trashëguara nga buxheti i vitit 2024, per vitin 2025”.

Bashkia Mirditë, administron dhe menaxhon fondet, sipas funksioneve buxhetore të miratuara, si më poshtë:

### **Funksioni 1 SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE**

Funksioni - 111: Planifikim menaxhim administrim

Funksioni - 112: Çeshtje Financare dhe Fiskale

Funksioni - 117: Gjendja civile

### **Funksioni 3 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE**

Funksioni - 314: Sherbimet policise vendore

Funksioni - 328: Mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtja civile”

### **Funksioni 4 ÇESHTJE EKONOMIKE**

Funksioni - 413: Mbeshtetje per zhvillim ekonomik

Funksioni - 422: Sherbimet bujqesore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit

Funksioni - 424: Menaxhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit

Funksioni - 426: Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Funksioni - 452: Rrjeti rrugor rural

Funksioni - 476: Zhvillimi i turizmit

### **Funksioni 6 STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT**

Funksioni - 614: Planifikim urban vendor

Funksioni - 626: Sherbimet Publike vendore

Funksioni - 633: Furnizimi me uje

Funksioni - 637: Ujesjelles dhe Kanalizime

### **Funksioni 8 ARGETIMI KULTURA DHE FEJA**

Funksioni - 813: Sport dhe argetim

Funksioni - 822: Trashegimia kulturore, eventetartistike dhe kulturore

Funksioni - 823: Integrimi Evropjan & ndihmes se huaj

### **Funksioni 9 ARSIMI**

Funksioni - 912: Arsime baze perfshire arsime parashkollor

Funksioni - 923: Arsime i mesem i pergjithshem

Funksioni - 924: Arsime profesional

### **Funksioni 10 MBROJTJA SOCIALE**

Funksioni - 014: Punonjesit social

Funksioni - 043: Kujdesi social per familjet dhe femijet

Funksioni - 091: Emergjencat Civile

Burimet e financimit te buxhetit te Bashkise, vijne nga dy burime:

**Nga burimet e veta vendore,** ku perfshihen te ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera, donacione,dhe te ardhura qe trashegohen.

**Nga burimet qendrore,** ku perfshihen transferta e pakushtezuar, transferta e pakushtezuar sektoriale per funksionet e transferuara, transferta specifike per mbrojtjen civile dhe transferta e kushtezuar.

**Buxheti i vitit 2025, në total në 000/leke me të gjitha burimet e financimit, paraqitet si më poshtë:**

000/lekë

|            | Burimet Buxhetore                                | 2023        | 2024        | 2025 (Shtator - Dhjetor) |                   |                 |
|------------|--------------------------------------------------|-------------|-------------|--------------------------|-------------------|-----------------|
|            |                                                  | Fakti       | Fakti       | Plani Fillestar          | Plani i Rishikuar | Fakti Kumulativ |
| <b>2.1</b> | <b>TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME</b>  | 159,070,000 | 296,651,343 | 330,935,526              | 346,262,259       | 0               |
| 2.1.1      | Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme         | 159,070,000 | 284,745,842 | 278,816,285              | 288,816,285       | 0               |
| 2.1.2      | Rritja e nivelit të pagave                       | 0           | 11,905,501  | 52,119,241               | 52,119,241        | 0               |
| 2.1.3      | Fond shtesë nga Kuvendi                          | 0           | 0           | 0                        | 5,326,733         | 0               |
| <b>2.2</b> | <b>TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE</b>      | 155,774,000 | 198,887,983 | 216,795,544              | 221,119,859       | 0               |
| 2.2.1      | Konviktet e arsimit parauniversitar              | 20,763,000  | 23,462,670  | 24,166,550               | 24,166,550        | 0               |
| 2.2.2      | Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor     | 48,295,000  | 82,007,046  | 72,323,370               | 72,323,370        | 0               |
| 2.2.3      | Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës      | 17,955,000  | 0           | 21,447,922               | 21,447,922        | 0               |
| 2.2.4      | Arsimi parauniversitar                           | 8,571,000   | 9,316,202   | 9,688,229                | 9,688,229         | 0               |
| 2.2.5      | Mbrojtja nga zjarri                              | 15,866,000  | 25,810,373  | 28,748,632               | 31,724,632        | 0               |
| 2.2.6      | Mbrojtja sociale                                 | 0           | 0           | 0                        | 0                 | 0               |
| 2.2.7      | Administrimi i pyjeve                            | 13,823,000  | 18,068,693  | 18,790,238               | 18,790,238        | 0               |
| 2.2.8      | Rrugët                                           | 20,789,000  | 23,162,854  | 23,889,188               | 23,889,188        | 0               |
| 2.2.9      | Ujitja dhe Kullimi                               | 9,712,000   | 17,060,145  | 17,741,415               | 17,741,415        | 0               |
| 2.2.1<br>0 | Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti" | 0           | 0           | 0                        | 0                 | 0               |
| 2.2.1<br>1 | Menaxhimi i mbetjeve urbane                      | 0           | 0           | 0                        | 0                 | 0               |
| 2.2.1<br>2 | Të tjera                                         | 0           | 0           | 0                        | 1,348,315         | 0               |
| <b>2.3</b> | <b>TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA</b>                 | 930,465,000 | 385,086,183 | 0                        | 164,677,363       | 0               |
| 2.3.1      | Për funksione të deleguara                       | 901,165,000 | 377,321,475 | 0                        | 0                 | 0               |
| 2.3.2      | Për projekte të veçanta                          | 29,300,000  | 7,764,708   | 0                        | 164,677,363       | 0               |

|                                       | Burimet Buxhetore                                    | 2023                 | 2024                 | 2025 (Shtator - Dhjetor) |                      |                   |
|---------------------------------------|------------------------------------------------------|----------------------|----------------------|--------------------------|----------------------|-------------------|
|                                       |                                                      | Fakti                | Fakti                | Plani Fillestar          | Plani i Rishikuar    | Fakti Kumulativ   |
| <b>2.4</b>                            | <b>TRANSFERTË SPECIFIKE</b>                          | 0                    | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| 2.4.1                                 | Transferte specifike                                 | 0                    | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| <b>3</b>                              | <b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>                 | 21,800,000           | 22,392,540           | 18,000,000               | 18,000,000           | 0                 |
| 3.1                                   | Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura | 12,775,000           | 12,329,510           | 10,000,000               | 10,000,000           | 0                 |
| 3.2                                   | Renta minerare                                       | 20,000               | 12,704               | 0                        | 0                    | 0                 |
| 3.3                                   | Tatimi mbi të ardhurat personale                     | 9,005,000            | 10,050,326           | 8,000,000                | 8,000,000            | 0                 |
| 3.4                                   | Të tjera                                             | 0                    | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| <b>4</b>                              | <b>GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA</b>                | 0                    | 0                    | 0                        | 1,200,000            | 0                 |
| <b>4.1</b>                            | <b>TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE</b>       | 0                    | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| 4.1.1                                 | Transferta nga i njëjti nivel qeverisje              | 0                    | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| <b>4.2</b>                            | <b>GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME</b>                  | 0                    | 0                    | 0                        | 1,200,000            | 0                 |
| 4.2.1                                 | Grante të Tjera të Brendshme                         | 0                    | 0                    | 0                        | 1,200,000            | 0                 |
| <b>4.3</b>                            | <b>GRANTE TË HUAJA</b>                               | 0                    | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| 4.3.1                                 | Grante të huaja                                      | 0                    | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| <b>5</b>                              | <b>HUAMARRJA</b>                                     | 0                    | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| 5.1                                   | Huamarrja afatshkurtër                               | 0                    | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| 5.2                                   | Huamarrja afatgjatë                                  | 0                    | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| <b>6</b>                              | <b>TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR</b>                  | 63,370,000           | 131,194,560          | 0                        | 243,744,431          | 0                 |
| 6.1                                   | Trashëgimi pa destinacion                            | 45,985,000           | 131,194,560          | 0                        | 243,744,431          | 0                 |
| 6.2                                   | Trashëgimi me destinacion                            | 17,385,000           | 0                    | 0                        | 0                    | 0                 |
| <b>TOTALI I TË ARDHURAVE TË NJVQV</b> |                                                      | <b>1,372,129,000</b> | <b>1,094,118,599</b> | <b>632,731,070</b>       | <b>1,062,003,912</b> | <b>77,201,647</b> |

Buxheti i Bashkisë Mirditë, për periudhën e 12 mujorit për vitin 2025, duke përfshirë burimet e financimit: transferte e pakushtezuar e pergjithshme, transferte e pakushtezuar sektoriale, fondet e rindertimit, te ardhurat e veta dhe e ardhur jashte limitit (e paplanifikuar) është planifikuar në vlerën 1,062,003,912 lekë.

**SHENIM:** Ky plan perbehet nga celjet fillestare te transfertes sektoriale, transfertes se

pergjithshme, planifikimit te te ardhurave, trashegimeve 2024 per 2025 ( ne te cilat eshte perfshire edhe fondi i trasheguar per rindertimin 164,677,363 leke) dhe shtesat sipas aktit normativ nr 11 dt 19.12.2025 ne shumen 5,326,501 leke, grandit te perfomances ( transferte e pergjithshme) ne shumen 1,348,314 leke. Theksojme se ne sistemin e thesarit (sipas situacionit perfundimtar te rakorduar me thesarin per Buxhetin Plan-Fakt) shumat 5,326,501 leke dhe 1,348,314 leke nuk jane te shperndare ne plan buxheti sepse nuk kishim vendimmarrje keshilli , per efekt kohe dhe jane tek trashegimet 2025 per 2026.



### **3. Realizimi i të ardhurave të Bashkisë Mirditë nga burimet e veta për vitin 2025**

Viti 2025 ka qenë një vit me realizim të mirë përsa i përket realizimit të të ardhurave.

Kjo analizë ka për qëllim të paraqesë në mënyrë të detajuar masën e realizimit të të ardhurave dhe arsyet e rezultateve. Bashkia Mirditë të ardhurat e saj i siguron përmes taksave dhe tarifave nga bizneset dhe familjet që janë të ardhura të drejtpërdrejta, gjithashtu në mënyrë indirekte me anë të institucioneve të tjera që derdhin për llogari të bashkisë sipas përqindjeve përkatëse në bazë të ligjit 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve të sipas kriterëve të përcaktuar me ligj.

Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet në:

1. Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
2. Ligjin nr. 9920 datë 26.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Mirditë nr. 100 datë 24.11.2021 “Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë”.

Rëndësi e veçantë i është dhënë zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet bashkëpunimit me njësitë administrative dhe kryetarët e fshatrave, mbajtjes së dëgjësive publike, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë. Gjithashtu dhe procedurat e ndryshimeve ligjore në vazhdimësi, ndërgjegjësimi i bizneseve dhe famljeve për pagesa, ka bërë të mundur të gjendemi përballë një ndjeshmërie më të lartë të arkëtimeve. Objektivat kryesisht janë të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal brenda kuadrit ligjor dhe shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit të biznesit, duke ruajtur rritjen e të ardhurave. Shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin. Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, janë ulja e taksave të pronës deri në minimumin ligjor të lejuar, mbështetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe

ambulantët etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit.

Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqësore, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e arkëtimeve nga viti në vit. Këto politika të lehtësimit fiskal, shoqëruar paralelisht me përmiresimin e vazhdueshëm të shërbimit, kanë ndikuar pozitivisht edhe në objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes. Është mundur të bëhet implementimi i regjistrave të saktë elektronikë të kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye ju kushtua vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve taksapaguese. Grupet e terrenit në çdo vit ushtrojnë verifikime të vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitalizimin e tyre, me efekt arritjen e rezultateve të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesorë të të ardhurave.

Pagesa e familjarëve është në pritshmëritë e duhura edhe për vitin 2025. Janë bërë pagesa dhe të viteve të mëparshme gjatë këtij viti, që ka rritur ndjeshëm të ardhurat nga pagesa e familjeve.

Ka patur një realizim jashtë pritshmërive dhe planit për:

Taksën vjetore të qarkullimit të mjeteve të përdorura që mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, edhe pse ky tejkalim nuk është në vlerat e viteve të mëparshme.

Tatimit mbi të ardhurat personale që mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Performanca të mirë përse i përket arkëtimeve ka pothuajse në çdo zë të përcaktuar si taksë apo tarifë.

### **Kategorizimi i të ardhurave**

#### **- Taksat vendore:**

- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë
- Taksa e fjetjes në hotel

- Taksa e hapësirës publike
- Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
- Taksa e qirasë nga fondi pyjor
- Taksat e ndara:
  - Taksa vjetore e e qarkullimit të mjeteve
  - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, agjent tatimor ASHK
  - Taksa e rentës minerare
  - Tatimi mbi të ardhurat personale
- Tarifat vendore
  - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
  - Tarifa për ndriçimin publik
  - Tarifa për gjelbrimin
  - Tarifa të shërbimit administrativ
  - Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
  - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
  - Tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj
- Të ardhura të tjera:
  - Të ardhura nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
  - Të ardhura nga kundravajtjet administrative
  - Të ardhura nga sekuestre dhe zhdëmtime
  - Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve
  - Te ardhura nga donacione/sponsorizime
  - Të ardhura të tjera (komision si agjent tatimor).

**Realizimi i të ardhurave nga të ardhurat vendore 2025 sipas evidencës së realizimit të koordinuar me thesarin**

|                               | 000/leke      |               |
|-------------------------------|---------------|---------------|
|                               | <b>Plan</b>   | <b>Fakt</b>   |
| Të ardhura nga taksat         | 32 530        | 26 214        |
| Të ardhura nga taksat e ndara | 25 150        | 26 799        |
| Të ardhura nga tarifat        | 17 334        | 16 903        |
| Të ardhura të tjera           | 9 986         | 9 223         |
| <b>Totali</b>                 | <b>85 000</b> | <b>79 139</b> |

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për 12/mujorin e vitit 2025 janë në vlerën 79 139 mijë Lekë. Në këtë vlerë është e përfshirë në zërin e të ardhurave të tjera një kontratë dhurimi me vlerë 1 200 000 lekë, që realisht nuk i përket të ardhurave të realizuara nga bashkia dhe kthim pagese e cila duhej te kthehej ne kapitullin 01 por gabimisht ne sistemin e thesarit eshte regjistruar kapitull 05 (te ardhura) në vlerën 737 596 lekë. Të ardhurat reale janë në vlerën 77 201 620 lekë. Në krahasim me planin sipas kategorive, ato përfshijnë: të ardhurat nga taksat 80%, nga taksat e ndara 106% të ardhurat nga tarifat 97% dhe të ardhurat nga burime të tjera 92%.

## Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin

Realizmi i të ardhurave për vitin 2025 ka qene në masën 93% e kundrejt planit vjetor.


000/lekë

|            |                                                                             | Plani<br>viti 2025 | Realizimi<br>Viti 2025 | Krahasimi<br>ne % |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------|--------------------|------------------------|-------------------|
|            | <b>LLOJET E TË ARDHURAVE</b>                                                |                    |                        |                   |
| <b>A</b>   | <b>TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA</b>                                        | <b>85000</b>       | <b>79139</b>           | <b>93</b>         |
| <b>A.1</b> | <b>TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE</b>                                         | <b>32530</b>       | <b>26214</b>           | <b>81</b>         |
|            | <b>Taksa mbi pasurinë e paluajtshme</b>                                     | <b>10258</b>       | <b>9076</b>            | <b>88</b>         |
|            | Taksa mbi ndërtesën                                                         | 7239               | 7282                   | 101               |
|            | Taksa mbi tokën bujqësore                                                   | 665                | 174                    | 26                |
|            | Taksa mbi truallin                                                          | 2054               | 1367                   | 67                |
|            | Taksa mbi transaksionet e pasurisë                                          | 300                | 253                    | 84                |
|            | <b>Taksa vendore në shërbimin hotelier</b>                                  | <b>150</b>         | <b>28</b>              | <b>19</b>         |
|            | <b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</b>              | <b>2500</b>        | <b>918</b>             | <b>37</b>         |
|            | <b>Taksa e tabelës</b>                                                      | <b>2330</b>        | <b>1884</b>            | <b>81</b>         |
|            | <b>Taksa e hapësirës publike</b>                                            | <b>386</b>         | <b>209</b>             | <b>54</b>         |
|            | <b>Taksa e qirasë nga fondi pyjor</b>                                       | <b>16906</b>       | <b>14099</b>           | <b>83</b>         |
|            | <b>Taksa e përkohëshme 1</b>                                                |                    |                        |                   |
|            | <b>Taksa e përkohëshme 2</b>                                                |                    |                        |                   |
| <b>A.2</b> | <b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)</b>                               | <b>25150</b>       | <b>26799</b>           | <b>107</b>        |
|            | <b>Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme</b> |                    |                        |                   |
|            | <b>Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura</b>                 | <b>15000</b>       | <b>15875</b>           | <b>106</b>        |
|            | <b>Taksa e rentës minerare</b>                                              | <b>150</b>         | <b>121</b>             | <b>81</b>         |
|            | <b>Taksa mbi të ardhurat personale</b>                                      | <b>10000</b>       | <b>10803</b>           | <b>108</b>        |
|            | <b>Taksa të tjera</b>                                                       |                    |                        |                   |
| <b>A.3</b> | <b>TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE</b>                                        | <b>27320</b>       | <b>24926</b>           | <b>91</b>         |
|            | <b>Tarifa me menaxhimit te mbetjeve</b>                                     |                    |                        |                   |
|            | Tarifa e pastrimit për familjet                                             |                    |                        |                   |
|            | Tarifa e pastrimit për institucionet                                        |                    |                        |                   |
|            | Tarifa e pastrimit për biznesin                                             |                    |                        |                   |
|            | <b>Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve</b>                         | <b>15000</b>       | <b>14840</b>           | <b>99</b>         |
|            | <b>Tarifa për ndriçimin publik</b>                                          | <b>635</b>         | <b>464</b>             | <b>73</b>         |
|            | Tarifa për ndriçimin publik nga familjet                                    |                    |                        |                   |
|            | Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet                               |                    |                        |                   |
|            | Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi                                     |                    |                        |                   |
|            | <b>Tarifa për gjelbërimin</b>                                               |                    |                        |                   |
|            | Tarifa për gjelbërimin nga familjet                                         |                    |                        |                   |
|            | Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet                                    |                    |                        |                   |
|            | Tarifa për gjelbërimin nga bizneset                                         |                    |                        |                   |
|            | <b>Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë</b>                      |                    |                        |                   |
|            | Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë                             |                    |                        |                   |
|            | <b>Tarifa për dhënien e liçensave, lejeve e autorizimeve</b>                | <b>1700</b>        | <b>1599</b>            | <b>94</b>         |
|            | <b>Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit</b>                     |                    |                        |                   |

|            |                                                                                   |             |             |            |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------|-------------|------------|
|            | Tarifa për vulosje veterinare të bagëtime të therura                              |             |             |            |
|            | Tarifa e liçensimit të veprimtarive të transportit                                |             |             |            |
|            | Tarifa e parkimit për mjetet e liçensuara dhe vendparkime publike                 |             |             |            |
|            | Tarifa për dhënie liçense për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj   |             |             |            |
|            | Tarifa për pyejt dhe kullotat dhe asetet                                          |             |             |            |
|            | Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksj                                       |             |             |            |
|            | Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave                  |             |             |            |
|            | Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille                               |             |             |            |
|            | Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet) |             |             |            |
|            | Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj                                      |             |             |            |
|            | <b>Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj</b>                 |             |             |            |
|            | Bibloteka                                                                         |             |             |            |
|            | Muzeumet                                                                          |             |             |            |
|            | Teatri                                                                            |             |             |            |
|            | Qendra kulturore e fëmijëve                                                       |             |             |            |
|            | Pallati i sportit                                                                 |             |             |            |
|            | Qendra Komunitare                                                                 |             |             |            |
|            | Mensa (Konviktet)                                                                 |             |             |            |
|            | Kopshtet                                                                          | 2000        | 2388        | <b>119</b> |
|            | Çerdhet                                                                           | 1640        | 1006        | <b>61</b>  |
|            | <b>Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime</b>                                |             |             |            |
|            | <b>Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit</b>                                |             |             |            |
|            | <b>Tarifa e përkohëshme</b>                                                       | 845         | 300         | <b>36</b>  |
|            | <b>Tarifa të tjera</b>                                                            | <b>5500</b> | <b>4329</b> | <b>79</b>  |
| <b>A.4</b> | <b>TË ARDHURAT E TJERA</b>                                                        | <b>0</b>    | <b>1200</b> | <b>0</b>   |
|            | <b>Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë</b>                                   |             |             |            |
|            | <b>Kthimi nga investimet kapitale</b>                                             |             |             |            |
|            | <b>Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë</b>                       |             |             |            |
|            | <b>Kthimi nga partneriteti publik privat</b>                                      |             |             |            |
|            | <b>Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet</b>                                |             |             |            |
|            | <b>Shitja e mallrave dhe shërbimeve</b>                                           |             |             |            |
|            | <b>Kundravajtjet administrative (Gjobat)</b>                                      |             |             |            |
|            | <b>Sekuestrime dhe Zhdëmtime</b>                                                  |             |             |            |
|            | <b>Kuotat e anëtarësisë së bashkive</b>                                           |             |             |            |
|            | <b>Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore</b>                           |             |             |            |
|            | <b>Grante nga kontrata dhurimi</b>                                                |             | 1200        |            |
|            | <b>Shitja e aseteve financiare</b>                                                |             |             |            |
|            | <b>Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme</b>                            |             |             |            |
|            | <b>Të tjera</b>                                                                   |             |             |            |

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin nivelin e realizimit të të ardhurave në lidhje me planin 2025 për kategorite e taksave, taksave të ndara, tarifave dhe të ardhurave të tjera sipas tabelës së mësipërme.

|               | Të ardhura nga taksat | Të ardhura nga taksat e ndara | Të ardhura nga tarifatat | Të ardhura të tjera | Totali |
|---------------|-----------------------|-------------------------------|--------------------------|---------------------|--------|
| Plan 2025     | 32530                 | 25150                         | 27320                    | 0                   | 85000  |
| Realizim 2025 | 26214                 | 26799                         | 24926                    | 1200                | 79139  |



Zërat kryesorë, që janë me tejkallim në krahasim me planin e vitit 2025 janë të ardhurat nga taksat e ndara: të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura, të ardhurat nga tatimi i të ardhurave personale. Të ardhurat për këto zëra janë realizuar me tejkallim si rezultat i zgjerimit së bazës taksapaguese. Pavarësisht se dhe për vitin 2025 kemi tejkallim të planit të të ardhurave, diferenca e tejkallimit në kahasim me vitet e tjera është më e ulët sepse parashikimi i të ardhurave për vitin 2025 është bërë më real. Zërat ndikues me mosrealizim sipas pritshmërive janë taksa e tokës bujqësore dhe tksa e hotelit. Kjo ndodh për arsye se po shihet një largim i familjarëve dhe braktisja e tokës bujqësore. Gjitashtu dhe taksa e hotelit është në vlra shumë të ulëta për arsye se bujtinat de hotelet ekzistuese nuk kanë paraqitur akoma regjistrin që mbajnë për numrin e fjetjeve në hotel.

## Realizimi i të ardhurave sipas Njësive Administrative

Dihet që përqendrimin më të madh aktivitetet e kanë në zonat urbane. Si bizneset, po ashtu dhe numri i familjeve është i përqendruar në 3 qytetet kryesore Rrëshen, Rubik dhe Reps. Njësitet Administrative luajnë një rol të vogël në realizim. Njësitet me realizimin më të ulët janë ato Kaçinar, Kthellë dhe Selitë që kanë gjithashtu numrin më të vogël të bizneseve.


Pesha në përqindje e në realizimit të të ardhurave sipas Njësive Administrative

|                               |     |
|-------------------------------|-----|
| Njësia Administrative Rrëshen | 60% |
| Njësia Administrative Rubik   | 20% |
| Njësia Administrative Orosh   | 10% |
| Njësia Administrative Fan     | 5%  |
| Njësia Administrative Kthellë | 2%  |
| Njësia Administrative Selitë  | 2%  |
| Njësia Administrative Kaçinar | 1%  |

## Analiza e peshës specifike sipas kategorive

Në përgjithësi, realizimi për vitin 2025 është rreth 30% për çdo zë në krahasim me totalin e realizimit. Kemi një luhatje shumë të vogël të peshave specifike që zënë çdo zë.

Grafiku i mëposhtëm peshën e të ardhurave sipas kategorive:






### Analiza e peshës specifike sipas kategorive

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar peshën specifike të zërave kryesor të realizuar për vitin 2025. Siç shihet dhe në tabelë, peshën kryesore e zënë taksat e ndara dhe të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve dhe kullotave, si në vitet e mëparshme. Për vitin 2025 ka një realizim më të mirë dhe të taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrimit në krahasim me vitin 2024, ku dallohet dhe rritja në përqindje e peshës specifike të tyre.

| Nr | Taksa                                                   | Pesha specifike |
|----|---------------------------------------------------------|-----------------|
| 1  | Taksa mbi ndërtesën                                     | 9.77%           |
| 2  | Taksa mbi tokën bujqësore                               | 0.23%           |
| 3  | Taksa mbi truallin                                      | 1.83%           |
| 4  | Taksa mbi transaksionet e pasurisë                      | 0.34%           |
| 5  | Taksa vendore në shërbimin hotelier                     | 0.04%           |
| 6  | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 1.23%           |
| 7  | Taksa e tabelës                                         | 2.53%           |
| 8  | Taksa e hapësirës publike                               | 0.28%           |
| 9  | Taksa e qirasë nga fondi pyjor                          | 18.92%          |
| 10 | Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura    | 21.31%          |
| 11 | Taksa e rentës minerare                                 | 0.16%           |
| 12 | Taksa mbi të ardhurat personale                         | 14.50%          |
| 13 | Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve            | 19.92%          |
| 14 | Tarifa për ndriçimin publik                             | 0.62%           |
| 15 | Tarifa për dhënien e liçensave, lejeve e autorizimeve   | 2.15%           |
| 16 | Kopshtet                                                | 3.20%           |
| 17 | Çerdhet                                                 | 1.35%           |

Grafiku vijues paraqet peshën specifike sipas zërave kryesorë të ardhurave të veta të realizuara pëvitin 2025.




### Fluksi monetar mujor i të ardhurave të veta, viti 2025

Tabela e të ardhurave në mënyrë progresive sipas muajve për vitin 2025 në 000/lekë

| Muaj        | I    | II    | III   | IV    | V     | VI    | VII   | VIII  | IX    | X     | XI    | XII   |
|-------------|------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Te ardhurat | 6272 | 13032 | 15834 | 25271 | 29448 | 39331 | 48326 | 52725 | 54015 | 63969 | 68689 | 79139 |

## Grafiku i fluksit monetar



Sipas grafikut shihet që të ardhurat janë rritur në mënyrë të njëtrajtshme gjatë muajve. Nivel pak më të lartë të arkëtimit paraqet muaji korrik si shkak i përfundimit të afatit të kështit të parë të pagesave dhe përqindja më e madhe e arkëtimeve është në muajt tetor, nëntor, dhjetor. Kjo ka ndodhur si shkak i afrimit të afatit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi si fund viti, si dhe vendosjes së kamatëvonesave për kështin e parë të pagesave për bizneset.

| Emertimi                | Viti              | Viti              | Viti              | Viti              | Viti              | Viti              |
|-------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
|                         | 2020              | 2021              | 2022              | 2023              | 2024              | 2025              |
| <b>Totali</b>           | <b>57,659,031</b> | <b>70,055,951</b> | <b>63,881,014</b> | <b>63,452,947</b> | <b>82,298,530</b> | <b>79,139,216</b> |
| <b>Taksat vendore</b>   | 25,429,386        | 27,593,239        | 15,575,006        | 7,087,763         | 33,435,826        | 26,214,249        |
| <b>Taksat e ndara</b>   | 17,182,974        | 17,850,478        | 19,723,515        | 21,800,661        | 22,684,484        | 26,798,970        |
| <b>Tarifat vendore</b>  | 15,046,671        | 7,356,560         | 14,989,186        | 34,564,523        | 24,978,220        | 16,902,708        |
| <b>Të tjera vendore</b> | 0                 | 17,255,674        | 13,593,306        | 0                 | 1,200,000         | 9,223,289         |

Nga viti 2020 deri në vitin 2025 shohim një luhatje të realizimit të të ardhurave ndër vite. Shohim që viti 2022 dhe 2023 ka një realizim në vlera të përafërta. Viti 2024 shënon një rritje të theksuar në krahasim me vitet mëpara. Kjo ka ndodhur nga pagesa e debitorëve të vitit 2022 dhe 2023 gjatë vitit më pas, dhe shpërndarja e taksës nga mjetet e përdorura dhe taksa e të ardhurave personale në vlera më të larta se në vitet e mëparshme. Në vitin 2025 kemi rënie të të ardhurave në kahsim me vitin 2024. Kjo diferencë që konsiderohet si rënie, ndodh si pasojë e pagesave të vitit dhe mosekzistencës së lartë të numrit të debitorëve për pagesë. Mëposhtë po paraqesim dhe paraqitjen grafike të pagesave ndër vite sipas kategorive të taksave dhe tarifave vendore sipas tabelës së shpjeguar me të dhënat përkatës.


#### 4. Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2025


Buxheti i Bashkisë Mirditë, gjatë vitit 2025, nga të gjitha burimet e financimit (transferete e pakushtezuar e pergjithshme, transferete e pakushtezuar sektoriale, transferete e kushtezuar dhe te ardhurat e veta) u realizua në shumën 1,093,411 mije lekë, me nivel realizimi 79.10%.

000/leke

| Emertimi          | Plani Korrigjuar | Fakti            | Realizimi ne % |
|-------------------|------------------|------------------|----------------|
| Paga dhe Sigurime | 506,456          | 465,392          | 91.89%         |
| Shpenz.Operative  | 105,043          | 79,589           | 75.77%         |
| Transferime       | 508,495          | 399,406          | 78.55%         |
| Investime         | 262,366          | 149,024          | 56.80%         |
| <b>Totali</b>     | <b>1,382,360</b> | <b>1,093,411</b> | <b>79.10%</b>  |


Realizmi i shpenzimeve, ne 000/leke, me te gjitha burimet e financimit





Peshen me te madhe të realizimit në përqindje e zënë pagat që janë, në masën 43 % në shumën 465,392 mijë lekë (efekti i rritjes se pagave) .

#### Pesha specifike e shpenzimeve totale për vitin 2025







Shpenzimet per paga rreth 63 % jane realizuar me burim financimi Burimet e Veta (qe jane transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e realizuara nga vete bashkia) , rreth 36 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale, dhe 1 % me Transferte te Kushtezuar(qe është gjendja civile).

Shpenzimet operative rreth 68 % jane realizuar me Burimet e veta, 28 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale dhe 4 % me Transferte te Kushtezuar.

Shpenzimet per transferime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 95 % (bonus qeraje per familjet e pastrehë, PAK + NDE dhe fondi i emergjencave) , me Burimet e veta 4 % (per shperblime dalje ne pension dhe ndihme financiare nga fondi rezerve i bashkise per raste familjeve ne nevojë) dhe 1% nga transferte e pakushtezuar sektoriale (ndihma financiare per familjet e demtuara nga fatkeqesi natyrore)

Shpenzimet per investime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 4% ,me Burimet e veta 83 % dhe me Transferte e pakushtezuar sektoriale 13 %.

Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve te financimit paraqitet si me poshte:



Realizimi i shpenzimeve per te gjitha programet ne **000/leke** , ne periudhen vitin 2025 ne Matrice paraqitet si me poshte:

|          |                                     | Paga dhe Sigurime    |                       |                | Shpenzime operative  |                       |                | Transferime          |                       |                | Investime            |                       |                | Totali               |                       |                |
|----------|-------------------------------------|----------------------|-----------------------|----------------|----------------------|-----------------------|----------------|----------------------|-----------------------|----------------|----------------------|-----------------------|----------------|----------------------|-----------------------|----------------|
| Programi | EMERTIMI                            | Plani fillestar 2025 | Plani korrigjuar 2025 | Realizimi 2025 | Plani fillestar 2025 | Plani korrigjuar 2025 | Realizimi 2025 | Plani fillestar 2025 | Plani korrigjuar 2025 | Realizimi 2025 | Plani fillestar 2025 | Plani korrigjuar 2025 | Realizimi 2025 | Plani fillestar 2025 | Plani korrigjuar 2025 | Realizimi 2025 |
|          |                                     | Totali               | Totali                | Totali         | Totali               | Totali                | Totali         | Totali               | Totali                | Totali         | Totali               | Totali                | Totali         | Totali               | Totali                | Totali         |
| AA133    | APARATI DHE DREJTIMI I BASHKISE     | 124,075              | 124,021               | 111,810        | 23,321               | 29,200                | 29,071         | 700                  | 16,293                | 10,804         | 6,800                | 13,474                | 5,376          | 154,896              | 182,988               | 157,061        |
